UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINË

| Pranuar me: 21.09.2023 | | | |
|---|---|---|---|
| Nj. org. | Numër | Sasia | Vlera |
| 01 | 4560 | 3 | |

# RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

| | |
|---|---|
| Fakulteti | FSHMN-Departamenti i Kimisë |
| Lëndët | Grup lëndësh nga kimia organike (dy bashkëpuntorë) |
| Kandidatët e paraqitur | Msc. Veprim Thaçi<br>Msc. Ilirjana Osmani,<br>Msc. Qëndresa Istrefi,<br>Msc. Ariana Aliu,<br>Msc. Ardian Dervishaj,<br>Msc. Mimoza Koskoviku,<br>Dr. Sc. Dua Danjolli Hashani |

<u>Komisioni vlerësues</u>

| | |
|---|---|
| 1. Kryetar | **Prof. dr. sc. Ramiz HOTI, - kryetar** |
| 2. Anëtar | **Prof. dr. sc. Arben HAZIRI, anëtar** |
| 3. Anëtar | **Prof. asoc. dr. sc. Hamit ISMAILI, anëtar** |

| Nr. | Emri dhe mbiemri | Grada shkencore | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata | | | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime | | | Mosha (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Thirrja akademike | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik | Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë) | Nota Ba. | Nota Ma. | Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë | | | | |
| 1 | **Veprim Thaçi** | **Msc.** | | | | **7.64** (8.43) | **9.18** | | **1981** | **15** | **JO** | **PO** |
| 2 | **Ilirjana Osmani** | **Msc.** | | | | **8.59** | **8.82** | | **1995** | **1 (3)** | **JO** | **PO** |
| 3 | Qëndresa Istrefi | Msc. | | | | 8.22 | 9.06 | | 1996 | 1 | JO | JO |
| 4 | Ariana Aliu | Msc. | | | | 8.00 | 8.82 | | 1996 | - | JO | JO |
| 5 | Adrian Dervishaj | Msc. | | | | 8.26 | 9.12 | | 1996 | - | JO | JO |
| 6 | Mimoza Koskoviku | Msc | | | | 8.84 | 9.35 | | 1995 | 1 | JO | JO |
| 7 | Dua Danjolli Hashani | Dr.sc. | | | | 7.69 (8.27) | - | | 1990 | - | JO | JO |

**Ass. Msc. Veprim Thaçi** është i lindue më 24. 10. 1981 në Shkarashnik të komunës së Malishevës. Kandidati është i zgjedhur në thirrjen asistent në FSHMN të Universitetit të Prishtinës në vitin 2011 (Vendimi nr. 4/57, dt. 12. 12. 2011) dhe në vitin 2016 (vendimi nr. 3/345, dt. 07. 11. 2016). Ka të përfunduara studimet Bsc. në programin Kimi Inxhinjerike në Departamentin e Kimisë të FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare 7.64, si dhe studimet themelore në FSHMN të Universitetit të Tetovës, me notë mesatare 8.43, ku ka marrë gradën Profesor i diplomuar i Kimisë. Studimet e masterit në programin Kimi Organike me Biokimi i ka përfunduar në Departamentin e Kimisë të FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare 9.18. Studimet e doktoratës i ka regjistruar në Universitetin Shën Qirili dhe Metodij dhe është në fazën e fundit të këtyre studimeve.. Kandidati ka të publikuara një numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore në revista të indeksuara në platformat Web of Science dhe Scopus, si dhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shumë konferenca shkencore nga fusha e kandidatit. Ass. Msc. Veprim Thaçi në vazhdimësi ka qenë i angazhuar në mbajtjen e ushtrimeve nga lëndët e Kimisë organike në nivelin Bsc. dhe Master në Departamentin e Kimisë, si dhe të lëndës së Kimisë Organike për studentët e Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë. Përvoja e tij shumëvjeçare akademike në mbajtjen e ushtrimeve me studentë të të dy niveleve, si dhe aktiviteti e përvoja hulumtuese është treguar mjaftë e suksesshme. Kandidati ka ndjekur një numër të konsiderueshëm të trajnimeve e aftësimeve profesionale, që dëshmohet me certifikatat e deponuara në dosjen e tij të aplikimit.

**Msc. Ardian Dervishaj** është i lindue më 09. 09. 1996 në Tegernsee të Gjerrmanisë. Ka të përfunduara studimet Bsc. në programin Kimi në Departamentin e Kimisë të FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare **8,26**, ndërsa studimet e masterit në programin Kimi Organike i ka përfunduar në Departamentin e Kimisë të FSHMN të Universitetit të Prishtinës me notë mesatare **9.12**. Kandidati ka një përvojë pune të suksesëshme në disa institucione e kompani, si në Ministrinë e Shëndetësisë, si inspektor sanitar, pastaj në kompaninë farmaceutike "Gentipharm" si Operator në departamentin e prodhimit, monitorimi dhe përcjellja e procesit të prodhimit. Kandidati ka disa trajnime që janë prezantuara me certifikata përkatëse. Gjatë studimeve Master ka treguar shkathtësi të veçanta në punë laboratorike.

**Msc. Ariana Aliu** është e lindur më 14. 08. 1996 në Vushtrri. Kandidatja ka përfunduar studimet e nivelit Bachelor në programin Kimi inxhinjerike me notë mesatare **8.00**. Studimet Master në programin Kimi Analitike dhe Mjedis po ashtu i ka të përfunduara në Departamentin e

Kimisë të UP-së, me notë mesatare gjatë studimeve 8.82. Kandidatja ka deponuar një numër certifikatash të pjesëmarrjes së aftësimit në punë praktike, ëorkshope, trajnime gara e univerziada.

Msc. Ilirjana Osmani ka lindur me 02.07.1995 në Mitrovicë. Kandidatja ka përfunduar studimet e nivelit Bachelor në programin Kimi me notë mesatare 8.59. Studimet Master në programin 'Kimi organike' po ashtu i ka të përfunduara në Departamentin e Kimisë të UP-së, me notë mesatare gjatë studimeve 8.82. Që nga viti 2016 ka një numër të madhë të praktikave në Institucione të ndryshme në Kosovë, ndërsa nga viti 2020 është mësimdhënëse e Kimisë në SHMU «Andon Zako Cajupi» në Vushtrri. Në vitin 2021 është Licensuar si mësimdhënse (Nr. 1029301, dt. 07.05.2021) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) për perudhën 5 vjeqare. Kandidatja ka përvojë në mësimdhënie dhe është vlerësuar maksimalishtë për mësimdhënie nga Menagjmenti i Institucionit ku punon. Kandidatja ka të botuara dy monografi nga fusha e kandidatës si dhe dy tekste universitare ne fushën e lëndëve në konkurs. Kandidaja Msc. Ilirjana Osmani ka dëshmuar pjesëmarrje si bashkëpuntore shkencore në dy projekte shkencore. Është pjesëmarrëse me një numër të madhë të kontributeve shkencore në konferenca ndërkombëtare dhe vendore. Ka te publikuar nje punim shkencore me impakt faktori. Po ashtu kandidatja posedon një çertifikatë deshmuese për pranimin e punimit tjetër i cili do te botohet në qershor 2024. Kandidatja ka aplikuar për pozitat 1 të konkursit të shpallur nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) për angazhim të bashkëpuntorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime (Nr. 1/909, te dt. 1.8.2023) për vitin akademik 2023/2024.

Msc. Qëndresa Istrafi është e lindur me 20.04.1996 në Husum të Gjermanis. Kandidatja ka përfunduar studimet bachelor në Kimi, me notë mesatare gjatë studimeve 8.22. Studimet e nivelit Master i ka të përfunduara në UP, konkretishtë ne Departamentin e Kimisë në programin "Kimi organike" në vitin 2020 me notë mesatare 9.06. Kandidatja ka të publikuar një punim shkencorë dhe po ashtu është pjesëmarrëse aktive në katër konferenca shkencore dhe ka të publikuara 3 procedings. Në CV-inë e kandidatës thuhet se punon si mësimdhënëse në shkollën private " International Maarif Schools of Kosova", por nuk ka dëshmuar me dokumentacion. Kandidatja është studente e doktoratës në Universitetin e

Tiranës. Kandidatja ka aplikuar për pozitat 1 të konkursit të shpallur nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) për angazhim të bashkëpuntorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime (Nr. 1/909, te dt. 1.8.2023) për vitin akademik 2023/2024.

Msc. Mimoza Koskoviku është lindur me 15.02.1995 në Prishtinë. Kandidatja ka notë mesatare 8.84 në nivel bachelor, dhe 9.35 në atë Master. Studimet Master i ka përfunduar në Kimi në programin "kimi organike". Kandidatja është studente e doktoratës në UP. Aktualishtë punon në cilësn e Menaxheres së kualitetit të barnave në Fabrikën e barnave "Gentipham". Kandidatja ka aplikuar për pozitat 1 të konkursit të shpallur nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) për angazhim të bashkëpuntorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime (Nr. 1/909, te dt. 1.8.2023) për vitin akademik 2023/2024.

Dr. Sc. Dua Danjolli Hashani është e lindur me 02.04.1990 në Prizren. Studimet Bsc. Kandidatja Dr. Sc. Dua Danjolli Hashani, ka notë mesatare 7.69 (bachelori në kimi inxhinierike ne FSHMN te UP-se) dhe 8.27 (bachelori në Biokimi analitike ne Universitetin e Tetoves, Maqedoni e veriut). Studimet Master i ka te perfunduara ne Fakultetin e Mjekësisë ne Universitetin e Belikesir, Turqi. Studimet e doktoratës i ka përfunduar në departamentin e Kimisë ne Universitetin e Trakya, Turqi. Në dokumentacion mungon nostrifikimi i diplomave master dhe Doktorates. Ka te publikuara 6 punime shkencore dhe 3 prezentime në konferenca. Kandidatja ka aplikuar për pozitat 1 të konkursit të shpallur nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) për angazhim të bashkëpuntorëve të jashtëm për ligjerata dhe ushtrime (Nr. 1/909, te dt. 1.8.2023) për vitin akademik 2023/2024.

Duke u bazuar në të dhënat e lartëshënuara vlerësojmë se për pozitën 1 (FSHMN), e plotesojnë nenin 7 paragrafin 3 të rregullorës për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkepuntorëve të jashtëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (nr. 1/95, dt. 24.06.2021) kandidatët: Msc. Veprim Thaci, Msc. Ilirjana Osmani, Msc. Qëndresa Istrefi, Msc. Ariana Aliu, Msc. Adrian Dervishaj dhe Msc. Mimoza Koskoviku. Kandidatja Dr. Sc. Dua Danjolli Hashani bie ndesh me nenin 7 (paragrafi 3, alineja 3.1) dhe nuk e plotëson nenin 5 (paragrafin 10) të

rregullorës për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpuntorëve të jashtëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (nr. 1/95, dt. 24.06.2021) për poziten 1.

Në mbështetje të gjithë kësaj dhe bazuar në rregulloren për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkepuntorëve të jashtëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (nr. 1/95, dt. 24.06.2021), i propozojmë Këshillit Shkencoro – Mësimor të FSHMN-së që për vitin akademik 2023/2024 të angazhon për bashkëpuntorë të jashtëm për ushtrime për poziten 1, kandidatët: **Msc. Veprim Thaçi** dhe **Msc. Ilirjana Osmani**.

Prishtinë, 21.09.2022

Komisioni:

1. **Prof. dr. sc. Ramiz HOTI, - kryetar**
2. **Prof. dr. sc. Arben HAZIRI, anëtar**
3. **Prof. asoc. dr. sc. Hamit ISMAILI, anëtar**